INDEP
INSTITUTE FOR DEVELOPMENT POLICY
INSTITUTI PËR POLITIKA ZHVILLIMORE

Agjenda e Gjelbër për Kosovën

Pesë Vite Pas: Përparimi, Mangësitë dhe Shanset për Tranzicion të Drejtë

Nëntor, 2025

TITULLI: **Agjenda e Gjelbër për Kosovën - Pesë Vite Pas: Përparimi, Mangësitë dhe Shanset për Tranzicion të Drejtë**

AUTOR: **INDEP, 2025**

Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:

Rockefeller Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondit të Vëllezërve Rockfeller. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive 3

1. Hyrje 5
   1.2. Metodologjia dhe Fushëveprimi 5

2. Shtylla I – Dekarbonizimi: Klima, Energjia and Mobiliteti 7
   2.1. Përshtatja dhe Zbutja e Ndryshimeve Klimatike 7
   2.2. Tranzicioni drejt Energjisë së Pastër 7
   2.3. Mobiliteti Smart dhe i Qëndrueshëm 9

3. Shtylla II – Ekonomia Qarkore: Prodhimi i Qëndrueshëm dhe Konsumi ... 12

4. Shtylla III – Eliminimi i Ndotjes: Ajri, Uji dhe Toka 14

5. Shtylla IV – Sisteme të Qëndrueshme të Ushqimit dhe Zonat Rurale 16

6. Shtylla V – Biodiversiteti: Mbrojtja dhe Restaurimi i Ekosistemeve 19

7. Perspektiva e Monitorimit dhe Zbatimit të Agjendës së Gjelbër 21

8. Përfundime 23

9. Rekomandime 25

Përmbledhje Ekzekutive

Pesë vjet pas miratimit të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, Kosova ndodhet në një pikë ku fjalët dhe dokumentet strategjike nuk mjaftojnë më. Duhet të matet me rezultate konkrete, të verifikueshme dhe të matshme. Analiza e pesë shtyllave kryesore tregon se bazat politike dhe ligjore janë ngritur, por zbatimi real është i ngadalshëm, i pabarabartë dhe shpesh pa efekt të drejtpërdrejtë në mjedis dhe ekonomi.

Në fushën e dekarbonizimit, Kosova ka miratuar Ligjin për Ndryshimet Klimatike dhe ka finalizuar draftin e Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë. Por mungojnë mekanizmat që i japin jetë këtyre dokumenteve. Sistemi për monitorim, raportim dhe verifikim të emetimeve ende nuk funksionon, nuk ka vendosur çmim të karbonit, ndërsa strategjia për dalje nga qymyri mungon. Në sektorin e ndërtesave, përafrimi me direktivat e BE-së është i plotë në letër, por certifikimi i performancës energjetike dhe programet e rinovimit janë të kufizuara dhe me ndikim të vogël. Burimet e ripërtëritshme kanë përparuar në rregullore, por jo në investime reale. Varfëria energjetike mbetet pa definicion ligjor, pa regjistër dhe pa masa të qarta mbrojtëse për qytetarët më të ndjeshëm.

Transporti është sektori me peshën më të madhe në ndotje dhe njëkohësisht me transformimin më të ngadaltë. Modernizimi teknik ka nisur, por pa standarde për automjetet e pastra, pa strategji kombëtare për zhvendosjen e trafikut drejt hekurudhës dhe autobusëve, dhe pa objektiva të emetimeve, ndikimi në klimë dhe në cilësinë e ajrit është minimal.

Në ekonominë qarkore, Kosova operon ende sipas modelit linear të prodhimit dhe konsumit. Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave është miratuar, por zbatimi është i pjesshëm. Mungon infrastruktura për ndarje, riciklim dhe sistemet e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit. Të dhënat janë të paplota dhe të pasinkronizuara, duke pamundësuar monitorimin dhe llogaridhënien. Pa reforma në raportimin e mbetjeve, Kosova nuk mund të ndërtojë politika të qëndrueshme qarkore.

Depolimi mbetet sfida më e madhe. Cilësia e ajrit në qytete tejkalon vazhdimisht kufijtë e lejuar, rrjetet e monitorimit nuk janë të akredituara dhe zbatimi i standardeve industriale është i ulët. Në ujëra, vonesat në zbatimin e direktivave për ujin dhe mungesa e investimeve në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza pengojnë përmirësime reale. Tokat bujqësore dhe industriale janë të ekspozuara ndaj ndotjes, ndërsa mungon çdo sistem i qëndrueshëm për monitorimin dhe rehabilitimin e tyre.

Sektori bujqësor po ecën ngadalë drejt përafrimit me standardet e BE-së. Programi për Zhvillim Rural 2023–2027 dhe ligjet e reja për tregun bujqësor janë hapa përpara, por Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe mekanizmat për kontroll të sigurisë ushqimore janë të nënfinancuar dhe pa kapacitete të mjaftueshme. Sistemet digjitale si Agjencia e Pagesave dhe LPIS nuk janë funksionale, ndërsa përfshirja e bujqësisë organike dhe inovacionit mbetet e kufizuar. Përjashtimisht, metoda LEADER ka nisur të zbatohet, por shumë grupe lokale janë joaktive dhe pa stabilitet financiar.

Në biodiversitet, Kosova ruan angazhimin në rrjete rajonale, por pa instrumente të forta kombëtare. Menaxhimi i zonave të mbrojtura mbetet i dobët, prerjet ilegale të pyjeve

vazhdojnë, ndërsa mungojnë planet kombëtare të restaurimit dhe atlaset e habitateve e specieve. Pa sistem monitorimi dhe financim të qëndrueshëm, masat për mbrojtjen e biodiversitetit mbeten simbolike.

Rishikimi i vitit 2025 i Planit të Veprimit të Agjendës së Gjelbër, i publikuar nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal me mbështetjen e Komisionit Evropian, e ka bërë qasjen më të matshme. Ai vendos afate konkrete, lidh masa me ligje specifike të BE-së dhe kërkon rezultate të verifikueshme. Kjo do të thotë se për Kosovën nuk mjafton përafrimi ligjor; duhet të garantojë zbatim, monitorim dhe buxhetim real. Sektori publik duhet të integrojë buxhetimin e gjelbër, të krijojë një Ecofond që bashkon të ardhurat nga taksa e karbonit dhe instrumentet e efiçiencës, dhe të forcojë Zyrën e Rregullatorit për Energji për të mundësuar komunitetet energjetike.

Në thelb, raporti e gjen Kosovën me një themel institucional të ngritur, por me boshllëqe të mëdha në ekzekutim. Dokumentet ekzistojnë, por ndikimi i tyre në ekonomi, mjedis dhe mirëqenie është ende i kufizuar. Tranzicioni i gjelbër kërkon lidership politik, koordinim ndërministror, transparencë publike dhe një angazhim të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe sektorit privat. Viti 2025 duhet të shërbejë si pikë nisjeje për matje reale të progresit deri në 2030, me qëllim që Kosova të kalojë nga faza e planeve në fazën e rezultateve.

1. Hyrje

Pesë vjet pas miratimit të “Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor”,[1] Kosova gjendet në një moment vendimtar për të vlerësuar jo vetëm përparimin e arritur, por edhe drejtimin strategjik të reformave që synojnë tranzicionin e gjelbër dhe të drejtë. Kjo agjendë, e miratuar në Samitin e Sofjes në nëntor 2020, përfaqësonte zotimin më ambicioz rajonal për ta përshpejtuar përafrimin me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe për ta integruar dimensionin klimatik në politikat zhvillimore. Në rastin e Kosovës, kjo kornizë është përkthyer në një sërë nismash sektoriale — nga përgatitja e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) deri te përfshirja në mekanizmat rajonalë të bashkëpunimit për energji të pastër dhe dekarbonizim.

Megjithatë, përparimi ka qenë i pabarabartë dhe shpesh i fragmentuar. Në mungesë të një statusi zyrtar kandidat për anëtarësim në BE, Kosova është përballur me kufizime institucionale dhe financiare që kanë ndikuar në shkallën e zbatimit të objektivave të Agjendës. Struktura ndërinstitucionale për koordinim klimatik mbetet e dobët, ndërsa politikat e efiçiencës dhe energjisë së rinovueshme kanë ecur përpara më shumë falë mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë sesa përmes buxheteve kombëtare. Për më tepër, mungesa e një vizioni të qartë për tranzicionin e drejtë në sektorët e varur nga qymyri, si ai i Obiliqit, rrezikon të prodhojë pasoja sociale që do ta ngadalësojnë transformimin e sistemit energjetik në dekadën e ardhshme.

Ky raport, përmes një analize të pesë shtyllave kryesore të Agjendës së Gjelbër — dekarbonizimit, ekonomisë qarkore, zbutjes së ndotjes, bujqësisë së qëndrueshme dhe mbrojtjes së natyrës — synon të japë një pasqyrë të plotë mbi përparimin, mangësitë dhe shanset që Kosova ka në horizontin e vitit 2030. Ai vendos theks të veçantë në ndërthurjen ndërmjet politikave klimatike dhe ekonomike, duke e trajtuar tranzicionin e gjelbër jo si një objektiv teknik, por si një proces politik dhe shoqëror që kërkon pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe drejtësi ndër-gjenerative.

1.2. Metodologjia dhe Fushëveprimi

Analiza është ndërtuar mbi një kombinim të metodave cilësore dhe kuantitative, me theks në vlerësimin krahasues të progresit të Kosovës në raport me pesë vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Burimet kryesore përfshijnë raportet e Komisionit Evropian për Kosovën (2021–2024), raportet e zbatimit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC) dhe të Green Agenda Regional Implementation (GARI), si dhe dokumentet zyrtare të institucioneve vendore për energjinë, klimën dhe mjedisin. Këto të dhëna janë plotësuar me publikime analitike të INDEP-it, që përfaqësojnë kontribut të rëndësishëm në monitorimin e politikave klimatike dhe të tranzicionit energjetik në nivel kombëtar.

[1] Regional Cooperation Council (2020), *Sofia Declaration on the Green Agenda for the Western Balkans*, e qasshme në: https://www.rcc.int/docs/562/sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkans (qasur në tetor, 2025).

Për të siguruar koherencë metodologjike, raporti ndjek strukturën e pesë shtyllave të Agjendës së Gjelbër dhe për secilën prej tyre identifikon:

- Veprimet e përcaktuara në udhërrëfyesin e Komisionit Evropian (Guidelines for Implementation, 2020);
- Përparimin aktual sipas burimeve të verifikuara rajonale dhe vendore;
- Mangësitë institucionale, financiare dhe ligjore që pengojnë përmbushjen e objektivave;
- Mundësitë e reja të financimit përmes instrumenteve të BE-së, si *IPA III*, *Reform and Growth Facility* dhe *Green Agenda Investment Plan*.

Të gjitha të dhënat e dytësore janë analizuar në mënyrë sasiore (nëpërmjet indikatorëve të përkthyer dhe të strukturës tabelare të këtij raporti) dhe cilësore (përmes vlerësimit të politikave ekzistuese dhe dokumenteve strategjike kombëtare). Për secilën shtyllë është ndërtuar një matricë e vlerësimit të progresit, e cila do të vizualizohet në grafikët krahasues për periudhën 2020–2025.

Nëpërmjet analizës së brendshme të INDEP-it, për indikatorët e identifikuar në të pesë shtyllat e Agjendës së Gjelbër, janë dhënë vlerësime kuantitative të tipit të shkallës së Likertit nga 1 deri në 5. Ky vlerësim i kuantifikuar i përgjigjet shkallës së standardizuar të vlerësimit që varion nga *"Pa progres"* deri në *"Plotësisht e zbatuar"* – një praktikë e përdorur nga Komisioni Evropian në raportet e progresit për Kosovën, por edhe nga INDEP në publikimet e mëparshme të tij. Shkalla e plotë e vlerësimit në matriksë është si vijon:



Pas përkthimit të indikatorëve nga dokumenti udhëzues i BE-së dhe pas përshtatjes së tyre për kontekstin e Kosovës, për secilën shtyllë është ndërtuar një matricë e vlerësimit të progresit. Këto matriksa janë përdorur për të gjeneruar rezultate përmbledhëse që pasqyrojnë nivelin e harmonizimit të Kosovës me Agjendën e Gjelbër gjatë periudhës 2020–2025. Në fazën përfundimtare, rezultatet e këtyre vlerësimeve janë sintetizuar në formën e scorecard-it të përgjithshëm dhe janë paraqitur vizualisht në grafikët krahasues që shfaqin performancën e Kosovës kundrejt mesatares rajonale.

Në fund, pas gjenerimit të matriksës për secilën nga shtyllat, është bërë një analizë e brendshme për të nxjerrë rekomandimet përkatëse, të ndara sipas fushës tematike. Duke qenë se ky raport synon të jetë një publikim i rregullt vjetor i Institutit INDEP, metodologjia e kalkulimit të vlerave dhe zbërthimit të tyre do të jetë një proces dinamik, që do të pasurohet në vitet e ardhshme me të dhëna krahasuese, përfshirë ato komunale dhe sektoriale. Viti 2025 shërben kësisoj si pikë referimi (baseline) për matjet e progresit në të ardhmen dhe për ndërtimin e një indeksi të qëndrueshëm të zbatimit të Agjendës së Gjelbër për Kosovën.

2. Shtylla I – Dekarbonizimi: Klima, Energjia and Mobiliteti

2.1. Përshtatja dhe Zbutja e Ndryshimeve Klimatike

Kosova ka vendosur themelet ligjore të politikës klimatike me miratimin e ligjit kornizë, por ato nuk janë ende shndërruar në instrumente funksionale të zbatimit. Hallka kritike është ngritja dhe operimi i mekanizmave MRVA (për Monitorim, Raportim, Verifikim dhe Akreditim) dhe vendosja e një rruge të qartë për çmimin e karbonit, e lidhur me objektivat 2030 dhe me planin kombëtar të përshtatjes. Në termat tanë të vlerësimit, përafrimi me "Ligjin e Klimës" vlerësohet 3/5: baza është hedhur, por mungon legjislacioni dytësor, kapaciteti njerëzor dhe një kalendar i besueshëm për ETS/karbon-pricing. NECP ka kaluar fazën e draftimit dhe konsultimit; për adoptim dhe operacionalizim – përfshirë kapitujt për varfërinë energjetike dhe koston sociale – e vlerësojmë 3/5. NAP/përshtatja mbetet 2/5, pasi dokumenti strategjik nuk është miratuar dhe rezistenca klimatike në infrastrukturë e planifikim territorial mbetet e nën-integruar. Këto konkluzione mbështeten nga të dhënat krahasuese rajonale të GARI (progresi i rishikimit të NECP 53% në 2023; kërkesat për MRVA dhe çmim karboni),[2] si dhe nga gjetjet e KE për nevojën urgjente të legjislacionit dytësor dhe forcimin e kapaciteteve.

Korniza e objektivave është më e qartë se sa kapaciteti për t'i arritur ato. Targeti i reduktimeve të GHG deri më 2030 dhe NDC e vitit 2025 nuk do të prodhojnë ndikim pa një mekanizëm monitorimi me tregues të matshëm vjetorë, lidhje me buxhetimin e programeve dhe një sekuencim të tranzicionit të drejtë për sektorët e varur nga qymyri.[3] Rreziku kryesor politik është "formalizimi pa zbatim": dokumente të miratuara, por pa instrumente fiskale e rregullatore që të ndryshojnë sjelljen e tregut dhe të konsumatorëve. Për ta adresuar, kërkohet një roadmap 24-mujor: MRVA e plotë, pilotim i çmimit të karbonit në sektorë të zgjedhur, dhe integrim i këtyre mekanizmave në NECP të adoptuar.

2.2. Tranzicioni drejt Energjisë së Pastër

Në efiçiencë të energjisë dhe ndërtesa, Kosova ka transpozim të avancuar të Direktivës për Per Performancë të Energjisë (EPBD), por zbatimi ngec te programet e rinovimit dhe te financimi i qëndrueshëm. Në vlerësimin tonë: EPBD/transpozimi është 4/5 (normativisht përpara, por i paplotë në zbatim); efikasiteti i energjisë 3.5/5 (masat ekzistojnë, por duhen ligji i ri për EE, auditime sistemike dhe monitorim i kursimeve); ndërsa skemave të rinovimit 3/5 (stanjacion në 73%: mungesë volumesh, mungesë "deep retrofit", dhe mungesë targetimi social). Kosova ka avancuar në Ligjin për Performancën e Energjisë. Është dizajnuar relativisht mirë Certifikata e Performancës së Energjisë dhe janë lëshuar certifikatat e para në Javën e Kosovës për Zhvillim të

---

[2] Regional Cooperation Council (2025), *Implementation Report on the Green Agenda for the Western Balkans* (NECP 53%, kërkesat për MRVA/karbon-pricing; NAP), në dispozicion në: https://www.rcc.int/pubs/140/implementation-report-gawb (qasur në tetor, 2025).

[3] European Commission (2025), *Kosovo Report 2025* (zbatimi i ligjit të klimës; MRVA/ETS; kapacitetet; NDC 2025; NECP/NAP), në dispozicion në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/ (qasur në tetor, 2025).

Qëndrueshëm (KSDW) në vitin 2024. Grupet e punës tashmë në nivel të Ministrisë janë duke punuar në zhvillimin e draft rregulloreve te fushës se performancës energjetike. Ky proces po bëhet me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe qasje të hapur.



Figura 1. Prodhimi bruto i EE. Burimi: ASK 2025

Në anën e BRE-ve, indikatorët e politikave janë përmirësuar ndjeshëm (ankandet e para, garancitë e origjinës), por ndikimi real në kapacitete është ende modest;[4] vlerësim 3/5 derisa të shohim MW të kontraktuara dhe të lidhura në rrjet. Dimensioni social është pika e dobët strukturore: varfëria energjetike mbetet pa përkufizim ligjor, regjistër dhe objektiv kombëtar – 2/5 – dhe pa masa të forta për modernizimin e sistemeve të ngrohjes në banesa me të ardhura të ulëta.

Ndonëse është miratuar Ligji për Promovimin e Burimeve të Ripërtrishme të Energjisë, ka një tejkalim të afateve ligjore për hartim të udhëzimeve administrative. Kjo veçanërisht është e kushtueshme në pjesën e hartimit të akteve nënligjore për rregullimin e kushteve, kritereve, përparësive dhe procedurave për themelimin e komuniteteve të energjisë dhe bashkësive për prodhim të energjisë nga BRE-të. ZRRE është vonuar jashtëzakonisht shumë në përmbushjen e obligimit ligjor për zhvillim të akteve nënligjore që do të mundësonin themelimin e këtyre bashkësive, me potencial për përshpejtim të tranzicionit dhe ulje të varfërisë energjetike.

[4] Regional Cooperation Council (2025), *Implementation Report on the Green Agenda for the Western Balkans* (EE/EPBD/REN treguesit; energjia e rinovueshme; varfëria energjetike), në: https://www.rcc.int/pubs/140/implementation-report-gawb (qasur në tetor, 2025).



Figura 2. Prodhimi dhe sasia e qymyrit. Burimi: ASK 2025

Në karburantet fosile, rënia e prodhimit të linjitit është zhvillim i mirëpritur, por nuk përbën një strategji të qartë. Pa një plan ekonomik-social të tranzicionit të qymyrit dhe pa fuqi zëvendësuese të BRE-ve, siguria e furnizimit e mban sistemin të varur te termocentralet ekzistuese. Kjo kërkon dy lëvizje paralele: (i) përshpejtim të ankandeve me mbyllje financiare, dhe (ii) paketa integrale "renovim + ngrohje e pastër" për komunitetet me varfëri energjetike. Të dyja kanë përfitim të madh: kosto më të ulëta në planin afatmesëm, ulje të importeve neto të karburanteve, dhe reduktim të faturave familjare.

2.3. Mobiliteti Smart dhe i Qëndrueshëm

Transporti tregon shenja të hershme transformimi, por pa një strategji të plotë "shift-to-rail/bus" dhe pa transpozimin e standardeve Euro/CO_2 impakti klimatik mbetet i kufizuar. Reforma hekurudhore ka përparuar në planin rajonal (regjistër elektronik, kontrata shumëvjeçare e mirëmbajtjes, draft-ligji i sigurisë), çka e vlerësojmë 3.5/5. Por përputhja me Paketën e 4-t hekurudhore dhe modernizimi i linjave strategjike (Linja 10; lidhja Durrës–Prishtinë) kërkojnë vendimmarrje financiare dhe kalendar investimesh të qartë prandaj në këtë aspekt, 2.5/5. Në lëvizshmërinë urbane, Planet e moblilitetit (SUMP) janë duke u hartuar në disa qytete, ITS është miratuar dhe 5G ka mbulim të gjerë; megjithatë, mungesa e standardeve të automjeteve të pastra, e rregullores së emetimeve CO_2 dhe e Direktivës së Automjeteve të Pastra i ul përfitimet nga 40 stacione karikimi dhe nga përgjigja e tregut të EV-ve. Për këtë nën-fushë vlerësojmë: infrastruktura EV/ITS 3/5, ndërsa rregullorja/standardet 2/5.

Për ta kthyer mobilitetin në kontribuues real të dekarbonizimit 2030, nevojitet një triadë politike: (1) transpozim i plotë i standardeve Euro/CO_2 dhe i direktivave të automjeteve të pastra, (2) SUMP me masa të forta kërkesë-menaxhuese (parkim, biletim multimodal, prioritizim për BUS/BIKE), dhe (3) paketa investimi rail-plus-urban që lidh projektet hekurudhore me rrjete autobusësh dhe qendrat urbane.

Indikatori	Statusi aktual (2025)	Pikësimi (1–5)
Përafrimi me Ligjin e Klimës së BE-së me vizionin për neutralitet klimatik deri më 2050.	Ligji për Ndryshimet Klimatike miratuar (2024), por pa legjislacion dytësor dhe mekanizma zbatimi.	**3**
Vendosja e objektivave të energjisë dhe klimës për vitin 2030.	Objektivat 2030 të përcaktuara në draft NECP dhe NDC (2025), por pa adoptim formal.	**3**
Hartimi dhe zbatimi i Planeve të Integruara për Energjinë dhe Klimën (NECP).	Draft dorëzuar në Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë; miratimi pritet në 2025.	**3**
Përgatitja dhe zbatimi i strategjive për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike (NAP).	Strategjia në përgatitje; NAP jo i miratuar.	**2**
Përafrimi me Sistemin e Tregtimit të Emetimeve të BE-së dhe/ose futja e instrumenteve të çmimit të karbonit.	MRVA në zhvillim; mungon mekanizëm i çmimit të karbonit.	**2**
Rritja e mundësive për zgjidhje të bazuara në natyrë për zbutje dhe përshtatje.	Projekte pilot (p.sh. BLRP) por mungon qasje sistemike në politika.	**2.5**
Pjesëmarrja në Paktin Klimatik Evropian ose mekanizma të ngjashëm.	Përfshirje rajonale në rrugën e GJBB; pa mekanizëm të veçantë kombëtar.	**2.5**
Përmirësimi i legjislacionit për dekarbonizimin progresiv të energjisë.	Draft paketë ligjore për EE, BRE dhe Energji në proces; vonesa në akte nënligjore.	**3**
Vlerësimi socio-ekonomik i ndikimit të dekarbonizimit.	Nuk ekziston analizë e plotë socio-ekonomike; boshllëk kritik.	**1.5**
Prioritizimi i efiçiencës së energjisë në të gjithë sektorët.	Progres i qëndrueshëm (EE 71%); nevojë për ligj të ri dhe auditime të plota.	**3.5**
Transpozimi dhe zbatimi i plotë i Direktivës për Performancën e Ndërtesave në Energjisë (EPBD).	Transpozimi I plotë, zbatimi pjesërisht në zhvillim.	**3**
Skemat e rinovimit për ndërtesat publike dhe private.	Programe në zbatim (BE, KEEF) por me volum të kufizuar.	**3**
Rritja e pjesës së burimeve të rinovueshme dhe investimeve.	Progres në politikat (ankande 100 MW), por kapacitetet mbeten modeste.	**3**

Ulja dhe eliminimi gradual i subvencioneve për qymyr.	Nuk ekziston plan i qartë për fazë-out; mbetet burim dominues.	**2**
Pjesëmarrja në “Rajonet e Qymyrit në Tranzicion”.	Kosova pjesë e iniciativës; mungon plan kombëtar tranzicioni.	**3**
Programet për trajtimin e varfërisë energjetike dhe skema financimi.	Draft ligji për energji përkufizon termin; mungon regjistër dhe objektiv.	**2**
Zhvillimi i infrastrukturës së transportit inteligjent dhe teknologjive inovative.	ITS miratuar, 5G 75% mbulim, AI në dogana.	**3.5**
Zbatimi i Planit Rajonal për Reformën Hekurudhore.	Implementim 70%; progres i dukshëm në siguri dhe mirëmbajtje.	**3.5**
Përcaktimi i korridoreve hekurudhorë dhe lumorë.	Linja 10 në zbatim; lidhja Durrës–Prishtinë përfunduar në fizibilitet.	**3**
Strategjia për zhvendosjen e trafikut nga rrugët.	Nuk ekziston strategji kombëtare “shift-to-rail/bus”.	**2**
Standardet teknike dhe digjitalizimi i transportit.	Përparim në ITS, por mungon transpozimi i standardeve Euro/CO_2.	**2.5**
Zbatimi i Planit Rajonal për Lehtësimin e Transportit.	One-stop points me RMV funksionale; progres i moderuar.	**3.5**
Zbatimi i Planit Rajonal për Sigurinë Rrugore.	Mekanizma monitorimi në zhvillim; fushata ndërgjegjësimi aktive.	**3**
Zbatimi i Planit të Veprimit për Rrugët.	Ligji për rrugët dhe ITS në zbatim; nevojë për mirëmbajtje sistematike.	**3**
Planet për qëndrueshmëri klimatike në rrjetet e transportit.	Ende pa integrim të plotë në politikat e infrastrukturës.	**2.5**
Planet e Qëndrueshme të Lëvizshmërisë Urbane (SUMP).	Në zhvillim në disa qytete (Ferizaj, Prizren, Suharekë).	**3**
Zgjidhjet e qëndrueshme të mobilitetit (karburante alternative).	Politikat ekzistojnë, por pa plan konkret rajonal.	**2.5**
Plani për ndërtimin e stacioneve të karikimit për automjete elektrike.	40 EVCS aktive; mungon plan kombëtar i kapaciteteve.	**3**
Bashkëpunimi rajonal në infrastrukturën e karburanteve alternative.	Në fazë shumë të hershme bashkëpunimi.	**2.5**

3. Shtylla II – Ekonomia Qarkore: Prodhimi i Qëndrueshëm dhe Konsumi

Pesë vitet e para të zbatimit të Agjendës së Gjelbër kanë shënuar hapat e parë strukturorë drejt ekonomisë qarkore në Kosovë, por tranzicioni ende nuk ka hyrë në fazën e vet funksionale. Kuadri politik dhe institucional është fragmentar dhe reaktiv, ndërsa ekonomia vazhdon të dominohet nga modeli linear "prodhim–konsum–hedhje", me mbetje të larta dhe rikuperim minimal të resurseve. Pavarësisht kësaj, janë bërë disa përparime që krijojnë terrenin për një qasje më të qëndrueshme në fazën 2025–2030.

3.1. Ristrukturimi industrial dhe qasja e ekosistemeve të qëndrueshme

Në këto pesë vite, industria e Kosovës ka nisur ta njohë tranzicionin e gjelbër si komponentë zhvillimore, por jo ende si mekanizëm konkurrues. Fondi Kosovar i Garancive Kreditore ka zgjeruar mbështetjen për sektorët prodhues, shërbimet dhe bizneset e udhëhequra nga gratë – një zhvillim që ka lehtësuar qasjen në financa me vlerë mbi 700 milionë euro deri në vitin 2024 (Regional Cooperation Council, *GARI Report 2025*). Ky zhvillim është domethënës për rimëkëmbjen e gjelbër, por mungon një politikë industriale qarkore, që të lidhë ndihmën financiare me performancën mjedisore dhe inovacionin.

Në nivel politikash, Kosova ka ruajtur përgatitje të moderuar në politikat industriale dhe të ndërmarrësisë. Strategjia e Industrisë 2030 dhe Reform Agenda nën Kornizën e Planit të Rritjes të BE-së kanë përfshirë dimensionin e "tranzicionit të gjelbër dhe dixhital", por zbatimi praktik i masave për mbështetjen e NVM-ve të gjelbra dhe qarkore mbetet nën 40% (European Commission, *Kosovo Report 2025*).

Në këtë drejtim, kërkohet një rikalibrim i politikave të mbështetjes industriale nëpërmjet kushteve të qarta për qasje në financim, duke lidhur kreditimin me kriteret ESG (Environmental, Social, Governance) dhe objektivat e efikasitetit të burimeve. Vetëm përmes kësaj lidhjeje, mbështetja financiare mund të kthehet në katalizator të ekonomisë qarkore.

3.2. Strategjitë qarkore dhe menaxhimi i burimeve

Në planin strategjik, Kosova ka bërë përparim të kufizuar në zhvillimin e strategjive të ekonomisë qarkore që mbulojnë të gjithë ciklin jetësor të produkteve. Deri në fund të vitit 2024 u miratua Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave me Planin e Veprimit 2024–2026, e cila parashikon objektiva për riciklim dhe zvogëlim të deponive, por pa një kornizë gjithëpërfshirëse qarkore që ta lidhë me prodhimin, konsumin dhe menaxhimin e burimeve. Zbatimi i saj është i ngadalshëm, ndërsa vonesat në vendosjen e sistemit të depozitimit të riciklueshëm (DRS) tregojnë mungesën e përgatitjes institucionale për instrumente të bazuara në treg.

Problematika e të dhënave mbetet pengesa kryesore për çdo politikë qarkore: mungojnë indikatorë të besueshëm për sasinë, përbërjen dhe trajtimin e mbeturinave,

ndërsa regjistrat komunalë janë fragmentarë dhe të pakrahasueshëm. Kjo pamundëson ndërtimin e një sistemi monitorimi të ekonomisë qarkore, që është kërkesë e drejtpërdrejtë e BE-së dhe e dokumentit të GARI-t.

Megjithatë, rasti i Prishtinës, ku në vitin 2024 u vu në funksion një landfill dhe qendër rajonale riciklimi, përbën një moment pozitiv dhe model të mundshëm për replikim në rajone të tjera. Ky projekt tregon se investimet e synuara në infrastrukturë mund të japin efekte të menjëhershme në menaxhimin rajonal të mbetjeve, edhe pse praktika e depozitimit mbetet ende dominante në nivel kombëtar.

3.3. Ndërgjegjësimi publik dhe konsumi i qëndrueshëm

Në dimensionin social të ekonomisë qarkore, fushata si *Let's Do It Kosovo* kanë shndërruar pastrimin vullnetar dhe edukimin mjedisor në traditë, duke e mbajtur të gjallë pjesëmarrjen qytetare në menaxhimin e mbetjeve dhe ndërgjegjësimin për ndarjen e tyre. Megjithatë, këto nisma nuk janë integruar ende në politikat publike të konsumit të qëndrueshëm, siç kërkohet nga Agjenda e Gjelbër.

Në nivel institucional, miratimi i ligjit të ri për mbrojtjen e konsumatorit (i kthyer për rishqyrtim nga Presidentja në 2025) është shenjë pozitive për avancimin e mekanizmave mbrojtës dhe për edukimin e konsumatorit, por ndërkohë mangëson ndërgjegjësimi sistematik për ndarjen e mbeturinave, zvogëlimin e konsumit plastik dhe konsumin etik. Një strategji kombëtare për konsum të qëndrueshëm dhe përgjegjës duhet të shoqërojë çdo reformë të menaxhimit të mbetjeve.

3.4. Inovacioni dhe Specializimi i Mençur

Nga ana e inovacionit, Kosova mbetet në fazë të hershme të zhvillimit të Strategjisë së Specializimit të Mençur (S3), që është shtylla bazë për tranzicionin drejt një ekonomie qarkore të udhëhequr nga inovacioni. Dokumenti strategjik mbetet në draft dhe ligji për Inovacion dhe Ndërmarrësi ende nuk është miratuar. Përkundër progresit në krijimin e Fondit për Inovacion, financimi për kërkim-shkencë dhe zhvillim vazhdon të jetë shumë nën 0.7% të PBB-së – norma ligjore e përcaktuar për këtë fushë.

Në praktikë, disa parqe industriale janë transformuar në zona eko-industriale, por pa standarde të plota të ekonomisë qarkore. Këto zhvillime tregojnë potencialin, por jo ende sistemin që ta bëjë inovacionin komponentë të tranzicionit të gjelbër.

Indikatori	Statusi aktual (2025)	Pikësimi (1–5)
Ekosistemet industriale të qëndrueshme	Fondi i Garancive Kreditore zgjeron qasjen, por mungon lidhja me kriteret ESG.	**3**
Strategjitë e ekonomisë qarkore	Strategjia e mbeturinave miratuar; mungon strategji gjithëpërfshirëse CE.	**2.5**
Infrastruktura e menaxhimit të mbetjeve	Qendra riciklimi në Prishtinë; ulje e fragmentimit, por shumë deponi ilegale.	**3**
Ndërgjegjësimi dhe konsumi i qëndrueshëm	Aktivizëm qytetar i gjallë, por mungon politikë e unifikuar kombëtare.	**3**

Specializimi i Mençur dhe inovacioni	S3 në draft; ligji për inovacion ende në pritje.	**2.5**

4. Shtylla III – Eliminimi i Ndotjes: Ajri, Uji dhe Toka

Pesëvjeçari 2020–2025 dëshmon se **depoluimi ka mbetur shtylla më e vështirë e Agjendës së** Gjelbër për Kosovën. Përkundër përpjekjeve institucionale për përmirësim të kornizës strategjike, rezultatet konkrete në cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës janë të kufizuara dhe shpesh të pabarabarta ndërmjet rajoneve. Ndikimi i drejtpërdrejtë mbi shëndetin publik dhe mbi ekosistemet urbane mbetet i lartë, ndërsa kapacitetet financiare dhe teknike të institucioneve janë të pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat e acquis të BE-së.
Në terma të përgjithshëm, Kosova ka bërë progres minimal, duke ruajtur pozicionin e "fazës së hershme të përgatitjes" në këtë fushë.

4.1. Ndotja e ajrit dhe përmirësimi i monitorimit

Në këto pesë vite, cilësia e ajrit ka mbetur problem strukturor, veçanërisht në zonat urbane të Prishtinës, Obiliqit dhe Mitrovicës, ku burimi dominues i ndotjes janë djegia shtëpiake, qymyri dhe ndotjet nga transporti. Përpjekjet për harmonizim me Konventën për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit kanë mbetur të pjesshme — është ratifikuar vetëm Protokolli i vitit 1984 për financimin afatgjatë të programit EMEP, ndërsa protokollet për ndotësit organikë të qëndrueshëm (POPs), metalet e rënda dhe oksidet azotike nuk janë ende të ratifikuara. Kjo vonesë kufizon bashkëpunimin rajonal dhe pjesëmarrjen në mekanizmat e matjes së ndotjes ndërkufitare.

Ndërkohë, emisionet e SO_2, NOx dhe pluhurit total të pezulluar janë rritur në 2024, duke tejkaluar kufijtë e lejuar dhe duke dëshmuar mungesë të masave korrigjuese. Kjo situatë nënvizon nevojën për krijimin e një sistemi të akredituar të monitorimit të cilësisë së ajrit, i cili aktualisht mbetet fragmentar dhe i paakredituar. Të dhënat e siguruara nga rrjetet komunale dhe ato të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) shpesh janë joadekuate për analiza të politikave.

Në këtë kontekst, zbatimi i Strategjisë së Cilësisë së Ajrit nuk ka ndodhur, ndërsa integrimi i Teknikave më të Mira të Disponueshme (BAT) në ndotjen industriale është shumë i kufizuar. Industria e rëndë dhe minierat vazhdojnë të veprojnë pa standarde të plota të Direktivës së Emetimeve Industriale, duke mbajtur rrezik të lartë për ajrin dhe shëndetin publik.

Për Kosovën, depolimi i ajrit kërkon një qasje të integruar që lidh politikat e ngrohjes shtëpiake, transportit dhe industrisë me mbikëqyrje të vazhdueshme, raportim publik dhe masa fiskale për ndotësit kryesorë.

4.2. Uji: nga strategjia te infrastruktura

Në fushën e ujërave, pesëvjeçari i fundit shënoi përpjekje për konsolidim të politikave, por pa ndryshime të ndjeshme në cilësinë e ujit dhe në trajtimin e ujërave të zeza.

Strategjia e Ujit 2023–2027 vendos objektiva të qarta për reduktimin e humbjeve në sistemin publik të furnizimit (non-revenue water), ndërsa autoriteti i pellgjeve lumore është forcuar me staf të ri, por pa rritje të kapaciteteve teknike. Ligji i ri për Ujin dhe planet e menaxhimit të pellgjeve mbeten në pritje, ndërkohë që nuk janë identifikuar aglomeratat dhe zonat e ndjeshme sipas Direktivës për Ujërat e Ndotura Urbane – pengesë që ndalon zhvillimin e infrastrukturës së trajtimit të ujërave.

Investimet e planifikuara për periudhën 2024–2030 nga Western Balkans Investment Framework (WBIF) përfshijnë dy projekte kryesore në furnizim dhe trajtim të ujit, por ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të zeza mbetet i vonuar dhe pa strategji për menaxhimin e baltës (sludge management). Mungesa e këtij hallke e zbeh ndikimin e çdo investimi ekzistues.

Në terma të përgjithshëm, zbatimi i acquis për ujin (Direktivat për Kuadrin e Ujit, Ujërat e Ndotura Urbane dhe Nitratet) është i papërfunduar, dhe progresi vlerësohet "i kufizuar". Modernizimi i infrastrukturës së monitorimit, megjithëse i përfshirë në dokumentet strategjike, nuk ka prodhuar rezultate të matshme deri më 2025.

4.3. Toka dhe ndotja industriale

Në menaxhimin e tokës dhe parandalimin e ndotjes industriale, Kosova nuk ka implementuar ende një sistem të integruar të monitorimit të tokës. Sidoqoftë, një numër studimesh të pavarura për ndotjen industriale (veçanërisht në zonat e Trepçës, Drenasit dhe Obiliqit) kanë krijuar bazën për një qasje më të koordinuar në të ardhmen. Sektori i bujqësisë, ndërkohë, përballet me probleme të degradimit të tokës dhe humbjes së sipërfaqeve bujqësore, ndërsa ndryshimet në Ligjin për Tokën Bujqësore dhe planin kombëtar për mbrojtjen e saj janë ende në fazë hartimi.

Në nivel rajonal, Kosova është angazhuar në hartimin e Planit Rajonal për Parandalimin e Ndotjes Plastike dhe Mbeturinave Detare, që shënon një hap drejt integrimit të mbrojtjes së tokës me menaxhimin e mbeturinave. Megjithatë, nuk ekzistojnë marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe të ratifikuara që fokusohen ekskluzivisht në ndotjen ndërkufitare të ajrit apo ujit – boshllëk që kufizon ndarjen e të dhënave dhe bashkërendimin me vendet fqinje.

Indikatori	Statusi aktual (2025)	Pikësimi (1–5)
Finalizimi i ratifikimit të Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit dhe protokolleve përkatëse.	Ratifikim vetëm i Protokollit EMEP (1984); pjesa tjetër në pritje.	**2**
Mbështetja e modelimit për vendosjen e objektivave për reduktimin e emetimeve të ndotësve kryesorë.	Modelimi rajonal (GAINS) përgatitur; nuk zbatohet kombëtarisht.	**2.5**
Hartimi dhe zbatimi i Strategjive të Cilësisë së Ajrit.	Pa progres; strategjia ende e paadoptuar.	**1.5**

Rritja e përdorimit të Teknikave më të Mira të Disponueshme (BAT).	Zbatim shumë i kufizuar; mungon integrimi në ndotjen industriale.	**2**
Krijimi i një sistemi adekuat të monitorimit të cilësisë së ajrit me rrjete të akredituara.	Rrjete ekzistuese pa akreditim; të dhëna të pjesshme.	**2**
Zbatimi i acquis për ujin (Direktivat e BE-së për ujërat).	Ligji i ri dhe planet e pellgjeve në pritje; progres i kufizuar.	**2.5**
Modernizimi i infrastrukturës së monitorimit të ujërave dhe arritja e statusit të mirë ekologjik.	Staf shtesë në autoritetet për pellgjet, por pa investime të plota.	**2.5**
Ndërtimi i infrastrukturës për trajtimin e ujërave të zeza.	Projekte WBIF në fazë planifikimi; mungon strategjia e baltës.	**2.5**
Integrimi i mbrojtjes së tokës në politika të tjera dhe krijimi i partneritetit rajonal.	Studime të ndotjes industriale ekzistojnë; mungon sistem monitorimi.	**2.5**
Nënshkrimi i marrëveshjeve rajonale për ndotjen ndërkufitare të ajrit dhe ujit.	Angazhim rajonal në kuadër të GJBB, por pa marrëveshje të dedikuara.	**2.5**

5. Shtylla IV – Sisteme të Qëndrueshme të Ushqimit dhe Zonat Rurale

Pesëvjeçari 2020–2025 e gjeti bujqësinë dhe sigurinë ushqimore në Kosovë me një bosht reformash të nisura, por jo të konsoliduara. Kuadri ligjor është përditësuar pjesërisht (organizimi i tregut për produktet bujqësore; programi 2023–2027 për zhvillim rural), ndërsa hallkat zbatuese – kontrolli zyrtar, gjurmueshmëria, laboratorët, shëndeti i bimëve/kafshëve – vuajnë nga burime njerëzore e financiare të pamjaftueshme. Mungesa e sistemeve kyçe për financimin e gjelbër në bujqësi (PA, LPIS, IACS) e lë vendin jo-gati për IPARD dhe kufizon investimet klimatike në ferma. Këto boshllëqe strukturore shpjegojnë pse përputhja me acquis në sigurinë ushqimore e fitosanitare mbetet "përgatitje e moderuar" dhe progresi në zbatim është i kufizuar.[5]

Në planin ligjor, Ligji për Organizimin e Tregut të Produkteve Bujqësore (12/2023) dhe Programi për Zhvillim Bujqësor e Rural 2023–2027 vendosin kornizën për ndërhyrje të orientuara nga tregu dhe për masa mjedisore; megjithatë akte nënligjore mungojnë dhe përputhja me acquis në fitosanitare e veterinari kërkon strategji zbatimi dhe plane modernizimi të kapaciteteve në thertore, tregje bagëtish dhe gjatë transportit. Ligji i ri për Shëndetin e Kafshëve është ende në pritje, ndërsa hartimi i bazës ligjore për novel

[5] European Commission (2025), *Kosovo Report 2025* në dispozicion në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/ (qasur në tetor, 2025).

food/GMO nuk ka nisur. Këto vonesa mbajnë të larta rreziqet për shëndetin publik dhe frenojnë qasjen në tregjet e BE-së.

Në bujqësinë organike, është aprovuar Plani i Zhvillimit të Tregut Organik 2024–2025 dhe parashtruar hapat drejt ligjit të ri për prodhimin/etiketimin organik, por adoptimi mungon; ndërkohë, zbatimi i Planit të Veprimit 2023–2026 nuk ka marrë ritmin e duhur. Përparim domethënës do të vijë vetëm me instrumente ekonomike (skema IPM, subvencione të lidhura me rezultate mjedisore, kupona analizash të tokës) dhe me kontroll më të rreptë të pesticideve dhe antimokrobikëve.

Dimensioni i njohurive dhe inovacionit ka lëvizur: shërbimi këshillimor ka bazë ligjore; janë nisur proceset për AKIS dhe për Agrikulturën Dixhitale (FAO, 2024); megjithatë mungon platforma funksionale shumë-palëshe dhe një kurrikul e re e zgjeruar për transfer teknologjie (ferma-model, demonstrime për eficiencë uji/energji, bujqësi të zgjuar ndaj klimës). Pa këto, grantet dhe garancitë kreditore (p.sh. përmes KCGF) nuk kthehen në produktivitete të qëndrueshme.

Në zonat rurale, instrumenti LEADER është integruar nominalisht (30 LAG të themeluara), por shumë LAG janë jo-aktive për shkak të paqëndrueshmërisë organizative/financiare. Konsolidimi i tyre dhe bashkimi i prodhuesve (organizatave të prodhuesve/co-ops) janë parakusht për zinxhirë vlere rezistentë dhe për t'i lidhur grantet me standarde mjedisore. Në menaxhimin e mbetjeve rurale, ka përparim normativ (strategjia e menaxhimit të integruar 2024–2026), por zbatimi është i pabarabartë dhe evidencat për pikat ilegale mbeten kontradiktore; kërkohet reformë e ndërmarrjeve komunale dhe modele rajonale për mbledhje, kompostim dhe riciklim (European Commission, *Kosovo Report 2025*; RCC, *GARI 2025*).

Boshti kritik për 2025–2027 është operacionalizimi i PA–LPIS–IACS, adoptimi i ligjeve kyçe (shëndeti i kafshëve; organikja), forcimi i FVA me staf dhe buxhet, dhe lidhja e pagesave me rezultate klimatike (reduktim GHG, eficiencë uji/energji, shëndet toke). Vetëm kështu Kosova e kthen përputhjen me acquis në fuqi konkurruese rurale dhe në reziliencë ndaj klimës.

Indikatori	Statusi aktual (2025)	Pikësimi (1–5)
Përafrimi i sektorit agro-ushqimor me standardet e BE-së për sigurinë ushqimore, shëndetin e bimëve e kafshëve dhe mjedisin; trajtimi i eflluentëve/plehut/mbetjeve	Kornizë ligjore e pjesshme; ligje/akte të rëndësishme në pritje; nevojë për plane modernizimi dhe përputhje të masave të PZhRR me acquis.	**3**
Forcimi i kontrolleve zyrtare dhe gjurmueshmërisë në gjithë zinxhirin ushqimor	Sistemet operacionale, por **FVA** me burime të pamjaftueshme; kërkohet rritje stafi/ekspertizë dhe kontrolle më të rrepta.	**2.5**
Promovimi i bujqësisë organike dhe reduktimi i produkteve kimike sintetike	Plan tregu 2024–2025 në zbatim; ligji organik në pritje; kontrolle të mangëta për pesticide/AMR.	**2.5**

Bashkëpunimi me shkencën/arsimin/biznesin dhe transferi i teknologjive (AKIS, dixhitalizimi)	Proces AKIS e programi i bujqësisë dixhitale i nisur; shërbimi këshillimor ekziston; mungon platformë funksionale dhe masa demonstrimi në shkallë.	**3**
Reduktimi i mbetjeve në zonat rurale	Strategji kombëtare e mbetjeve e miratuar; zbatim i pabarabartë; kërkohet reformë e ndërmarrjeve komunale dhe modele kompostimi.	**2.5**
Zhvillimi rural i qëndrueshëm me metodën LEADER	30 LAG të themeluara; shumë jo-aktive; mungon financim i qëndrueshëm dhe kapacitet menaxhues.	**2.5**
Mbështetje për investime në BRE, reduktim të GHG dhe përshtatje klimatike në bujqësi	PA/LPIS/IACS jo-operacionale; jo-gatishmëri për IPARD; barriera të larta financimi për ferma të vogla.	**2**

6. Shtylla V – Biodiversiteti: Mbrojtja dhe Restaurimi i Ekosistemeve

Pesëvjeçari 2020–2025 shënon një profil të përzier: Kosova ka ruajtur angazhimin në rrjete rajonale të ruajtjes (BLRP për rrisën ballkanike, LCIE/DPP-LCI për mishngrënësit e mëdhenj, Park Dinarides), por instrumentet kombëtare të planifikimit, menaxhimit dhe monitorimit nuk kanë avancuar në të njëjtën masë. Administrimi i zonave të mbrojtura mbetet i brishtë; menaxhimi i habitateve dhe kontrolli i presioneve (prerje të paligjshme, fragmentim, ndotje) janë nën standard, me boshllëqe serioze në të dhëna dhe në zbatim. Identifikimi i zonave të mundshme Natura 2000 është ende në fazë shumë të hershme; ndërkohë, Kosova merr pjesë si vëzhguese në projekte pilote të TSI për të përgatitur planet kombëtare të restaurimit – një hap i rëndësishëm, por i pamjaftueshëm pa bazë të qartë ligjore, financiare dhe institucionale (European Commission, Kosovo Report 2025, qassur në tetor, 2025).

Nga këndvështrimi rajonal, arkitektura e planeve strategjike 2030 (plan rajonal i biodiversitetit, raporte monitoruese, plane të restaurimit pyjor, qendra e informacionit dhe korniza e M&V) po ndërtohet gradualisht, dhe Kosova është e përfshirë në rrjete dhe nisma të bashkërendimit (p.sh., BLRP, Park Dinarides). Por kapaciteti për përkthim në masa vendore – kadastra e habitateve/specieve, zinxhiri i lejeve, vlerësimi i ndikimit, monitorimi i bazuar në indikatorë, dhe buxhetimi – mbetet i kufizuar. Kjo reflektohet edhe te ndërthurja me bujqësinë: boshllëqet në PA/LPIS/IACS dhe në qeverisjen e tokës e bëjnë të vështirë aktivizimin e pagesave për shërbimet ekosistemike dhe masat agro-mjedisore (RCC, GARI 2025, qassur në tetor, 2025).

Zgjidhjet e bazuara në natyrë (NbS) po promovohen në nivel WB6 (p.sh., ADAPT 2.0, 2024–2028), dhe Kosova mund t'i përdorë si urë midis objektivave të klimës dhe biodiversitetit (restaurim i peizazheve pyjore, korridore ekologjike, rehabilitim i lumenjve dhe zonave ujore). Sot, megjithatë, mungon analiza sistematike e përfitimeve të NbS dhe lidhjes klimë-biodiversitet në dokumentet vendore; pa këtë, ndërhyrjet rrezikojnë të mbeten projekte të izoluara, jo komponentë të një plani të restaurimit me objektiva të matur dhe financim të qëndrueshëm (European Commission, Kosovo Report 2025, qassur në tetor, 2025; RCC, GARI 2025, qassur në tetor, 2025).

Prioritetet 2025–2027 për ta kthyer Shtyllën V në motor të restaurimit janë tri:

- ✓ Korniza kombëtare e restaurimit: përfundimi i planeve kombëtare (në vijim të pjesëmarrjes TSI), përafrimi me objektivat e Kunming-Montreal GBF dhe operacionalizimi i indikatorëve të monitorimit (habitate/specie, lidhshmëri, presione).
- ✓ Infrastruktura e të dhënave dhe M&V: atlas i habitateve/specieve, protokolle monitorimi, platformë e hapur e të dhënave; ngritja graduale drejt një Qendre informacioni kombëtare të lidhur me rrjetin rajonal.
- ✓ Zbatimi në terren: paketa NbS "pyje-ujë-urban" (korridore ekologjike, restaurim pyjor me plane financiare, ringjallje e lumenjve), e integruar me masat agro-mjedisore dhe me menaxhimin aktiv të zonave të mbrojtura (plan menaxhimi, patrullime, rikthim habitatit).

Indikatori	Statusi aktual (2025)	Pikësimi (1–5)
Zhvillimi dhe zbatimi i Planit Strategjik për Biodiversitetin në Ballkanin Perëndimor 2030	Proces rajonal në zhvillim; Kosova e përfshirë në rrjete, por pa përkthim të plotë në masat vendore.	**2.5**
Hartimi i Raportit për Biodiversitetin në Ballkanin Perëndimor	Raportimi rajonal i parashikuar; kontributet e Kosovës jo të konsoliduara për mungesë të dhënash/monitorimi.	**2.5**
Hartimi i Planit Strategjik për Biodiversitetin në Ballkanin Perëndimor	Korniza rajonale po formësohet; kërkohet lidhje me objektivat kombëtare dhe buxhetimin.	**2.5**
Përgatitja e planeve për mbrojtje dhe restaurim të natyrës, përfshirë zonat detare	Pjesëmarrje vëzhguese në projekte TSI për planet e restaurimit; zona detare jo-relevante; menaxhimi i zonave të mbrojtura i dobët.	**2.5**
Zhvillimi dhe zbatimi i Planit për Restaurimin e Peizazheve Pyjore në Ballkanin Perëndimor	Nuk ka plan kombëtar funksional; presione të larta (prerje të paligjshme ≈ 40% e pyjeve publike të prekura).	**2**
Raport për mundësitë e restaurimit të pyjeve	Nuk evidentohet raport i posaçëm; boshllëqe të dhënash dhe inventari i pyjeve i papërditësuar.	**2**
Hartimi i Planit të Restaurimit të Pyjeve (përfshirë planin financiar)	Nuk ka plan të miratuar me kosto/afate; mungon kanalizimi buxhetor dhe burimet.	**2**
Analiza e përfitimeve të biodiversitetit nga NbS dhe integrimi në planet klimatike	NbS promovohet rajonalisht (p.sh., ADAPT 2.0); mungon analizë dhe integrim sistematik në dokumentet vendore.	**2.5**
Raport mbi lidhjet klimë–biodiversitet	Nuk ekziston raport kombëtar i dedikuar; mundësi për sinergji me NECP/NAP.	**2**
Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe zbatimi i Konventës për Diversitet Biologjik	Angazhim në rrjete (BLRP, Park Dinarides); zbatim vendor i kufizuar dhe mekanizma të dobët koordinimi.	**3**
Angazhim më i thellë me Konventat e OKB-së për Rio-n dhe pozicioni rajonal pas-2020	Referenca të përgjithshme; pa pozicion/implementim të detajuar në nivel vendi.	**2.5**
Krijimi i Qendrës së Informimit për Biodiversitetin në Ballkanin Perëndimor	Iniciativë rajonale e papërcaktuar për Kosovën; nuk ka nyje kombëtare funksionale të të dhënave.	**2**
Korniza për Monitorimin dhe Vlerësimin e Biodiversitetit	Nuk është operacionale; mungon atlas/kadastra e habitateve dhe protokollet e monitorimit.	**2**

Zhvillimi i Infrastruktures së Gjelbër dhe lidhshmërisë së ekosistemeve	Koncepti i pranishëm në nivel rajonal; projekte të izoluara; nuk ka plan lidhshmërie/korridore kombëtare.	**2.5**

7. Perspektiva e Monitorimit dhe Zbatimit të Agjendës së Gjelbër

Rishikimi i Planit të Veprimit të Agjendës së Gjelbër (GARI) i publikuar në vitin 2025 nga RCC, me mbështetjen e Komisionit Evropian, shënon një kthesë metodologjike dhe rregullatore: veprimet janë bërë më të targetuara, me afate të përcaktuara, të lidhura drejtpërdrejt me instrumente specifike të BE-së si European Climate Law, AFIR (Alternative Fuels Infrastructure Regulation) dhe Nature Restoration Regulation. Kjo nënkupton që monitorimi nuk do të bazohet më në përshkrime të përgjithshme progresi, por në verifikimin e rezultateve të matshme dhe të datuara (RCC, 2025, qassur në tetor, 2025).

Në Shtyllën I (Dekarbonizimi dhe Rezilienca Klimatike), veprimet e ripërcaktuara vendosin kalendar për përafrimin ligjor (p.sh. deri në 2029 për përditësimin e ligjeve të klimës) dhe e zhvendosin fokusin nga “transpozimi” tek operacionalizimi: ngritja e institucioneve MRVA, zbatimi i parimit EE1st, përforcimi i EPBD me objektiva rinovimi, korniza për investimet në BRE, si dhe elektrifikimi i TEN-T dhe hapja e tregut hekurudhor. Shtohet një theks i ri mbi sektorin e ngrohjes dhe ftohjes (H&C) dhe mbi tranzicionin e drejtë (dialog financimi, plane të tranzicionit për rajonet e qymyrit). Për Kosovën, kjo kthen kërkesat e përgjithshme të viteve të kaluara në një listë detyrimesh me afate që duhen integruar në NECP të adoptuar, në NAP dhe në buxhetin vjetor/mesatar-afatësh.

Në Shtyllën II (Ekonomia Qarkore), zhvendosja më e rëndësishme është përqendrimi te EPR-të (skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit) për rrjedhat kyçe të mbetjeve dhe te reduktimi-ripërdorimi-riciklimi me objektiva kuantitative (p.sh. ulje të landfillimit dhe rritje të normave të riciklimit deri më 2030). Këto kërkojnë rregullore të plota nënligjore, sisteme raportimi dhe trazabilitet operativ përgjatë zinxhirit. Për Kosovën, implikimi është i dyfishtë: (i) vendosje shpejt e EPR për ambalazh/WEEE me operim real (jo vetëm transpozim), dhe (ii) financim i dedikuar i infrastrukturës së ndarjes, grumbullimit dhe riciklimit, i cili sot është i nënfinancuar. Pa këto, objektivat 2030 rrezikojnë të mbeten jo-detyrues në praktikë.

Shtylla III (Eliminimi i Ndotjes) përqendrohet tani në përputhje deri më 2030 me standardet e cilësisë së ajrit, rritje të BAT sipas IED, si dhe transpozim të plotë të acquis-it të ujit dhe modernizim të monitorimit në përputhje me planet e menaxhimit të pellgjeve. Janë hequr veprime të përgjithshme (p.sh. ratifikime protokollesh) dhe është ndarë qartë transpozimi nga zbatimi me theks në arritjen e “good status” dhe akses të sigurt në ujë të pijshëm. Për Kosovën, kjo nënkupton që boshllëqet ekzistuese në ligjin për ujin, UWWTD, WFD dhe monitorimin duhet të mbyllen me paketa DSIP (dokumente strategjike zbatimi), përndryshe, do të kemi penalizime të shumfishta: mjedisore, shëndetësore dhe fiskale.

Në Shtyllën IV (Sistemet e Qëndrueshme të Ushqimit dhe Zhvillimi Rural), rishikimi vendos afate (2026–2030) për përafrimin agro-ushqimor, forcimin e kontrolleve zyrtare, promovimin e praktikave të qëndrueshme (përfshirë organiken), operacionalizimin e AKIS, si dhe rishpikjen e LEADER në kontekste ku kushtet lejojnë. U shtuan fusha si CNFM për pyjet dhe monitorimi i kapitujve 11/12/13. Për Kosovën, implikimi kyç është ngritja e kapaciteteve institucionale (FVA, laboratorë, inspektoriate), aktivizimi i sistemeve PA/LPIS/IACS dhe krijimi i linjave grant-kredi për fermat e vogla. Pa këto, hyrja në skemat e BE-së dhe performanca ndaj objektivave mjedisorë do të mbeten të pamundura (European Commission, *Kosovo Report 2025*, qassur në tetor, 2025; RCC, 2025, qassur në tetor, 2025).

Shtylla V (Biodiversiteti) formalizon sinkronizimin me Kunming-Montreal GBF dhe kërkon plane të restaurimit të natyrës të harmonizuara me Nature Restoration Regulation, FLR me ROAR deri në 2026, kornizë rajonale M&E dhe Hub informacioni. Për Kosovën, kjo do të kërkojë atlas/kadastër të habitateve e specieve, protokolle monitorimi, plane menaxhimi funksionale për zonat e mbrojtura dhe buxhetim të dedikuar për restaurim (pyje, lumenj, korridore ekologjike). Pa infrastrukturë të të dhënave, kontributi në mekanizmat rajonalë do të mbetet formal (RCC, 2025, qassur në tetor, 2025; European Commission, *Kosovo Report 2025*, qassur në tetor, 2025).

8. Përfundime

Pesë vite pas miratimit të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, progresi i Kosovës mbetet i mangët dhe kryesisht në nivel dokumentesh strategjike. Pavarësisht rritjes së ndërgjegjësimit institucional dhe miratimit të disa kornizave ligjore, zbatimi praktik është penguar nga mungesa e kapaciteteve administrative, vonesat në legjislacionin dytësor dhe mungesa e fondeve të qëndrueshme për projektet mjedisore.

Procesi i dekarbonizimit ka hyrë në fazën e institucionalizimit, por jo të zbatimit. Ligji për Klimën dhe Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën janë dokumente themelore, por pa një sistem funksional për monitorim, raportim dhe verifikim (MRVA) dhe pa një mekanizëm për çmimin e karbonit, ndikimi i tyre mbetet i kufizuar. Zbatimi real i tranzicionit të gjelbër mbetet i varur nga përgatitja për integrimin në Sistemin Evropian të Tregtimit të Emetimeve dhe nga përballimi i kostove sociale që do të shoqërojnë reduktimin gradual të qymyrit.

Në sektorin e energjisë, harmonizimi me Direktivën për Performancën e Energjisë në Ndërtesa është përparim i dukshëm, por rezultatet konkrete në terren janë të pakta. Skemat e rinovimit dhe masat për efiçiencë mbeten të kufizuara në përfshirje dhe pa ndikim të madh në reduktimin e konsumit total. Ndërkohë, varfëria energjetike vazhdon të mbetet pa adresim të qartë institucional dhe ligjor, duke e lënë tranzicionin e gjelbër të pabarabartë në ndikim shoqëror.

Burimet e ripërtëritshme të energjisë po fitojnë terren, por me ritëm të ngadaltë. Proceset e ankandeve dhe zhvillimi i garancive të origjinës përbëjnë hapa përpara, megjithatë investimet reale dhe kapacitetet e lidhura në rrjet janë ende minimale. Mungesa e akteve nënligjore që mundësojnë krijimin e komuniteteve energjetike e pengon pjesëmarrjen qytetare në tranzicionin energjetik.

Mobiliteti i qëndrueshëm mbetet një ndër sektorët më të pazhvilluar. Përkundër përpjekjeve për modernizimin e transportit publik dhe futjen e teknologjive të reja, mungesa e standardeve të automjeteve të pastra, rregulloreve të emetimeve dhe strategjive të integruara të transportit të gjelbër ka kufizuar ndikimin pozitiv në uljen e ndotjes urbane.

Në ekonominë qarkore, progresi është më shumë konceptual sesa praktik. Mungesa e të dhënave për mbetjet, infrastrukturës së ndarjes dhe riciklimit dhe sistemit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit e bën të vështirë ndërtimin e një ekonomie që rrotullohet rreth parimit të riciklimit dhe ripërdorimit. Edhe pse strategjia e menaxhimit të integruar të mbetjeve është miratuar, zbatimi i saj në nivel lokal është minimal dhe pa ndikim të dukshëm në reduktimin e ndotjes.

Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës mbetet një prej fushave më problematike. Cilësia e ajrit vazhdon të jetë alarmante në zonat urbane, me nivele të ndotjes mbi kufijtë e BE-së. Ujërat e ndotura urbane trajtohen pjesërisht, ndërsa mungesa e identifikimit të zonave të ndjeshme dhe e planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore pengon përmbushjen e detyrimeve sipas Direktivës së BE-së për Ujërat. Tokat bujqësore dhe industriale

mbeten të ekspozuara ndaj ndotjes për shkak të mungesës së sistemit të monitorimit dhe të planeve të restaurimit të tokës.

Sektori bujqësor ka bërë disa hapa përpara në harmonizimin me standardet e BE-së, por mbetet i fragmentuar dhe me kapacitete të kufizuara për zbatim. Ligji për Organizimin e Tregut të Produkteve Bujqësore është miratuar, por masat zbatuese janë vonuar. Përfshirja e komponentëve të qëndrueshmërisë në Programin për Zhvillim Rural 2023–2027 është pozitive, por mungon mbështetja efektive për bujqësinë organike dhe inovacionin teknologjik.

Institucionet përgjegjëse për sigurinë ushqimore, kontrollin fitosanitar dhe veterinar mbeten të nënfinancuara dhe me mungesë të stafit profesional. Kjo kufizon aftësinë për të zbatuar standardet e BE-së në zinxhirin ushqimor dhe për të garantuar produkte të sigurta dhe të qëndrueshme.

Për biodiversitetin dhe ekosistemet, Kosova ka mbetur në fazë të hershme të zbatimit. Pjesëmarrja në rrjete rajonale si Park Dinarides dhe programe ndërkufitare për mbrojtjen e faunës së rrallë, përfshirë rryshtin e Ballkanit, është pozitive, por mungojnë planet kombëtare të restaurimit dhe mekanizmat për menaxhimin e zonave të mbrojtura.

Pyjet dhe resurset natyrore përballen me kërcënime të vazhdueshme nga prerjet ilegale dhe mungesa e kontrollit institucional. Përkundër pjesëmarrjes në nisma rajonale për restaurimin e peizazheve pyjore, mungon një plan kombëtar i mirëfilltë që përcakton objektiva të matshëm për mbrojtjen e biodiversitetit dhe lidhshmërinë ekologjike.

Rishikimi i Planit të Veprimit të Agjendës së Gjelbër në vitin 2025 ka sjellë ndryshime thelbësore në strukturën e monitorimit, duke vendosur afate të qarta, objektiva të matshëm dhe lidhje të drejtpërdrejtë me legjislacionin e BE-së si Ligji Evropian për Klimën, Rregullorja për Infrastrukturën e Karburanteve Alternative dhe Rregullorja për Restaurimin e Natyrës. Kjo e vendos Kosovën përpara nevojës për harmonizim të plotë ligjor dhe për ndërtimin e kapaciteteve që garantojnë zbatim real dhe të matshëm të detyrimeve të reja.

Financimi i projekteve të gjelbra mbetet i kufizuar dhe i varur nga asistenca e jashtme. Mungesa e një sistemi të buxhetimit të gjelbër, të integruar në procesin e planifikimit publik, kufizon përfshirjen e qëndrueshmërisë mjedisore në politikat ekonomike dhe fiskale.

Në përfundim, pesëvjetori i Agjendës së Gjelbër gjen Kosovën me një bazë politike të konsoliduar, por me rezultate të pamjaftueshme në zbatim. Dokumentet strategjike janë miratuar, por ndryshimi i qëndrueshëm në mjedis, ekonomi dhe shoqëri ende nuk është arritur. Sfida kryesore mbetet kthimi i politikave në veprim konkret, me përgjegjësi të matshme, financim të qëndrueshëm dhe angazhim të përbashkët ndërmjet institucioneve, komuniteteve dhe sektorit privat.

9. Rekomandime

Shtylla I – Dekarbonizimi: Klima, Energjia dhe Mobiliteti

- Kuvendi i Kosovës, sapo të funksionalizohet, duhet të miratojë Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë (NECP) pas një rishikimi të shpejtë teknik dhe politik, për të azhurnuar objektivat dhe masat në përputhje me zhvillimet më të fundit të BE-së dhe Planin e Rishikuar të Veprimit të Agjendës së Gjelbër (2025).
- Ministria e Ekonomisë duhet të hartojë dhe të dërgojë për miratim në Kuvend Strategjinë Dalëse nga Qymyri, e cila të përfshijë një kalendar tranzicioni, masa sociale për komunitetet e prekura dhe instrumente financiare për rikualifikimin e punëtorëve të sektorit energjetik.
- Të themelohet Ekofondi i Kosovës si mekanizëm i vetëm kombëtar për financimin e tranzicionit të gjelbër, i cili të përfshijë në një platformë të vetme Fondin e Efiçiencës së Energjisë, të ardhurat nga taksa e karbonit dhe të gjitha të hyrat që burojnë nga parimi "ndotësi paguan".
- Të përfundohet korniza ligjore për zbatimin e sistemit MRVA (Monitorim, Raportim, Verifikim dhe Akreditim), si parakusht për hyrjen në fazën e vendosjes së çmimit të karbonit dhe përgatitjen për pjesëmarrje në Sistemin Evropian të Tregtimit të Emetimeve (ETS).
- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) duhet të miratojë pa vonesa aktet nënligjore që mundësojnë krijimin e bashkësive energjetike, me lehtësira të veçanta për konsumatorët e cenueshëm dhe për pronarët e banesave me të ardhura të ulëta.
- Të zbatohen masa konkrete për dekarbonizimin e sektorit të ngrohjes, përmes integrimit të burimeve të ripërtëritshme, rikuperimit të nxehtësisë së mbetur dhe investimeve në sisteme të kombinuara për ngrohje të pastër.
- Të miratohet Strategjia Kombëtare e Adaptimit ndaj Ndryshimeve Klimatike, e cila të përfshijë komponentët e infrastrukturës, bujqësisë, shëndetësisë dhe ujit, dhe të shërbejë si dokument udhëzues për investime publike dhe ndërkombëtare në fushën e reziliencës klimatike.
- Të zbatohet regjistri kombëtar i ndërtesave dhe të nisë certifikimi sistematik i performancës energjetike, në përputhje me Ligjin për Performancën e Energjisë në Ndërtesa dhe me direktivat e BE-së.
- Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Ekonomisë të hartojnë një plan të përbashkët për reduktimin e ndotjes urbane nga transporti, përfshirë standardet për automjetet e pastra, transpozimin e Direktivës së Automjeteve të Pastra dhe masat për transport publik elektrik.

Shtylla II – Ekonomia Qarkore: Prodhimi dhe Konsumi i Qëndrueshëm

- Të miratohet Strategjia Kombëtare për Ekonominë Qarkore, e cila të harmonizojë masat ndërmjet sektorit të prodhimit, mbetjeve dhe politikave industriale, duke synuar reduktimin e mbetjeve, rritjen e riciklimit dhe uljen e deponive ilegale.
- Ministria e Mjedisit duhet të vendosë sistemin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (EPR) për flukset kryesore të mbetjeve (paketim,

pajisje elektrike, bateri), me objektiva të qarta riciklimi deri në vitin 2030.
- Të krijohen qendra rajonale për riciklim dhe ripërdorim materialesh në bashkëpunim me komunat dhe sektorin privat, duke u bazuar në modelin e landfillit rajonal të Prishtinës.
- Të forcohen masat për ndërgjegjësimin e konsumatorëve, përfshirë programe edukimi mjedisor në shkolla, fushata për ndarjen e mbetjeve dhe reduktimin e konsumit të tepërt.
- Të shpejtohet procesi i zbatimit të Smart Specialisation Strategy (S3) duke përfshirë fushat e inovacionit të gjelbër dhe teknologjive qarkore në politikat industriale dhe të arsimit profesional.

Shtylla III – Eliminimi i Ndotjes: Ajri, Uji dhe Toka

- Të finalizohet procesi i ratifikimit të protokolleve të Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit, duke përcaktuar objektiva të matshëm për reduktimin e ndotësve kryesorë (SO_2, NO_x, $PM_{2.5}$).
- Ministria e Mjedisit duhet të përforcojë rrjetin kombëtar të monitorimit të cilësisë së ajrit, duke instaluar stacione të reja matëse të certifikuara dhe duke siguruar publikimin në kohë reale të të dhënave.
- Të modernizohet infrastruktura për menaxhimin e ujërave të ndotura, përmes investimeve në impiante të reja për trajtimin e ujit dhe përmirësimit të rrjeteve të kanalizimit.
- Të miratohet Ligji i ri për Ujërat dhe të zbatohet një sistem i integruar i menaxhimit të pellgjeve lumore, në përputhje me Direktivën e BE-së për Ujërat dhe Direktivën për Ujërat e Ndotura Urbane.
- Të integrohet mbrojtja e tokës në politikat e planifikimit hapësinor dhe bujqësor, përmes krijimit të një partneriteti rajonal për mbrojtjen e tokës dhe zhvillimit të një programi kombëtar të monitorimit të ndotjes dhe degradimit të saj.
- Të forcohet inspektimi dhe raportimi për ndotësit industrialë, duke vendosur në funksion sistemin për zbatimin e Teknikave më të Mira të Disponueshme (BAT).

Shtylla IV – Sistemet e Qëndrueshme të Ushqimit dhe Zonat Rurale

- Ministria e Bujqësisë duhet të digjitalizojë të gjitha skemat mbështetëse, për të rritur transparencën, qasjen e fermerëve dhe zvogëlimin e abuzimeve në subvencione.
- Të përfundohet ligji për shërbimet këshilluese bujqësore dhe zhvillimin rural, si bazë për zbatimin efektiv të Programit 2023–2027.
- Të zbatohet në praktikë Plani i Veprimit për Bujqësinë Organike 2023–2026, duke përfshirë masa për certifikimin e produkteve organike dhe krijimin e tregjeve të dedikuara për to.
- Të forcohet Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me burime njerëzore dhe financiare të mjaftueshme për të garantuar kontroll të plotë të zinxhirit ushqimor dhe përputhshmëri me standardet e BE-së.
- Të përfshihen teknologjitë e gjelbra dhe dixhitale në bujqësi, përmes platformës së propozuar për Sistemin e Njohurive dhe Inovacionit

Bujqësor (AKIS), që të ndihmojë fermerët në përshtatjen ndaj klimës dhe përdorimin efikas të burimeve.
- Të zgjerohet zbatimi i metodës LEADER për zhvillim rural, duke i bërë Grupet Lokale të Veprimit (LAG) funksionale dhe të qëndrueshme financiarisht.
- Të integrohen masat për reduktimin e gazeve serrë në bujqësi në politikat kombëtare për energji dhe klimë, përfshirë investimet në burime të ripërtëritshme dhe teknologji efikase në përdorimin e plehrave organike.

Shtylla V – Biodiversiteti dhe Restaurimi i Ekosistemeve

- Të miratohet Strategjia Kombëtare për Biodiversitet 2030, e harmonizuar me Kornizën Globale Kunming–Montreal dhe Strategjinë e BE-së për Biodiversitetin.
- Të përgatiten planet kombëtare të restaurimit të natyrës, në përputhje me Rregulloren e BE-së për Restaurimin e Natyrës, me objektiva të matshëm për restaurimin e pyjeve, habitateve ujore dhe zonave të degraduara.
- Të krijohet Qendra Kombëtare për Monitorimin e Biodiversitetit, si pjesë e një platforme rajonale për shkëmbim të dhënash dhe ndërtim kapacitetesh mbi mbrojtjen e specieve dhe ekosistemeve.
- Të forcohen masat kundër prerjeve ilegale të pyjeve dhe të rishikohet Ligji për Pyjet, duke parashikuar penalitete të rënda për shkatërrimin e habitateve natyrore.
- Të integrohet menaxhimi i biodiversitetit në politikat e zhvillimit rural dhe turizmit të qëndrueshëm, për të lidhur mbrojtjen e natyrës me përfitimet ekonomike lokale.

Shtylla Horizontale – Qeverisja, Financimi dhe Pjesëmarrja Publike

- Të forcohet qeverisja ndërinstitucionale për Agjendën e Gjelbër, përmes krijimit të një mekanizmi të përhershëm koordinues në nivel ndërministror.
- Të zbatohet buxhetimi i gjelbër në nivel qendror dhe lokal, me kategorizim të qartë të shpenzimeve që kontribuojnë në objektivat klimatike dhe mjedisore.
- Të rritet transparenca dhe pjesëmarrja qytetare në politikat e gjelbra, përmes publikimit të të dhënave, konsultimeve të hapura dhe përfshirjes së shoqërisë civile në proceset e vlerësimit të ndikimit mjedisor.
- Të përfshihen komunat në zbatimin e Agjendës së Gjelbër, me plane lokale për klimë dhe energji, si dhe me mbështetje për ndërtimin e kapaciteteve administrative dhe teknike.